



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100453/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.2, Tiranë.*

Drejtuar : KOMISARIATIT TË POLICISË NR. 2

TIRANË

Për djeni: Drejtues i Parë Rebani JAUPI
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 11.03.2021, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z.Besnik Deda, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standarteve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit (në mungesë të shefit të komisariatit) u takua me shefin e rendit në Komisarariatit e Policisë nr.2, z.Bernard Muça, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i rendit informoi grupin e inspektimit për gjendjen në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë pranë këtij komisariati, angazhimin e punonjësve të policisë që kryejnë detyrën në këto ambiente, për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i monitorimit i shoqëruar nga shefi i rendit, inspektoi në vend gjendjen e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, intervistoi personat e shoqëruar, si dhe vizitoi zyrat e punës të oficerëve të policisë gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr.2, Tiranë, me të cilët kontaktoi grupi i monitorimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Gjatë inspektimit, përgjithësisht u evidentua se punonjësit e policisë në mjediset e komisariatit, zbatonin protokollin shëndetësor për parandalimin e përhapjes të sëmundjes infektive COVID-19. Ata ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe në vende të aksesueshme (koridore) ishin vendosur dezifektant për pastrimin e duarve. Këto pajisje mbrojtëse ndodheshin dhe në ambientin e sigurisë dhe të shoqërimit të komisariatit, si dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm, rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për lyerjen dhe dezifektimin e dhomave të sigurisë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për pajisjen me krevat sipas kapacitetit fizik të dhomave të sigurisë;

2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave më vehte ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar apo shoqëruar, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore;
3. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e një ambjenti të përshtatshëm për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin;
4. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin më vehte të dhomës për kryerjen e vizitave mjeksore në ambientin e sigurisë.

Në përfundim të inspektimit, grupi i monitorimit konstatoi se, në ambjentet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatit e Policisë Nr.2 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatit e Policisë nr.2 Tiranë, ambienti i shoqërimit përgjithësisht ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, në të cilat parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vehte për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.¹

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte 3(tre) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe qëndrimin e shtetasve të rritur, femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit ishin me dimensione 4x3m, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme dhe të pajisura me karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Kapaciteti fizik për secilën dhomë shoqërimi, ishte për qëndrimin ulur të 4-5 personave. Dhomat e shoqërimit ishin të siguruara me dyer dhe mbylleshin me çelës.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësi për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por ato kishin nevojë për lysterje. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë teli, për arsye të sigurisë së personave që ndodhen në këto ambiente.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë më vehte për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Njëkohësisht edhe kryerja e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe komunikimi i masës së sigurisë të personave për kalimin nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, kryhet në zyrat e punës së punonjësve të policisë.

Korridori në mjedisin e shoqërimit monitorohej nga një kamera, ndërsa zyrat e punonjësve të policisë ku merren në pyetje personat e shoqëruar, nuk janë të monitoruara me sistemin

¹ *Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

e kamerave. Administrimi i kamerave, kryhej nga specialistët e IT në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë.

Në korridorin ku ndodheshin dhomat e shoqërimit, ishte një tualet i përbashkët për punonjësit e administratës dhe për personat e shoqëruar i kompletuar me lavaman, çezëm dhe nyje hidrosanitare, si dhe kishte ujë të rrjedhshëm.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e inspektimit, kishte një person të shoqëruar në mjediset e policisë së këtij komisariati, për interes të organit të prokurorisë për krimet e rënda. Ndërsa për periudhën Janar-Mars 2021 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 301 persona të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati.

Nga inspektimi u konstatua se, në korridorin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë nr.2 në Tiranë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe atyre të ndaluar/arrestuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit në zyrën e informacionit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë nr.2 në Tiranë, ambienti i sigurisë **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komisarariatit dhe kishte 2 (dy) dhoma sigurie. Njëra nga dhomat e sigurisë ishte me përmasa 3x3m, ndërsa dhoma tjetër ishte me përmasa 4x3m. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e 4 personave të ndaluar/arrestuar dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë, deri në transferimin e tyre për në I EVP. Nisur nga sipërfaqet dhe kubaturat e

dhomave, niveli i ndriçimit dhe ajrimit, si dhe kushtet materiale në të cilën ndodhen dhomat e sigurisë në këtë komisariat, konstatojmë se ato nuk i plotësojnë parametrat teknik dhe jetësor për ndërtimin e dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, MKPT e konsideron problematike numrin e vogël dhe kapacitetin e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë nr.2, pasi nga inspektimet është konstatuar se ky ambient është i pamjaftueshëm për të përballuar fluksin e personave të arrestuar dhe të shoqëruarve, si në rastin e protestave të qytetarëve të zhvilluara në muajin Dhjetor 2020, ku pati mbipopullime dhe një situatë tejet degraduese për këta persona, gjatë ditëve të qëndrimit në mjediset e policisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, lidhur me problematikat e evidentuara nga grupet e ekspertëve gjatë këtyre ditëve të protestave siç ishin mbipopullimi, mungesa në plotësimin e rubrikave të regjistrave për evidentimin e të dhënave të të shoqëruarve dhe të ndaluar/arrestuar, mos njoftimi në kohë i familjarëve, trajtim jo dinjitoz i të miturve, si dhe për mos respektimin nga punonjësit e policisë të protokollit shëndetësor për masat anti COVID-19, i ka trajtuar dhe adresuar ato nëpërmjet rekomandimeve përkatëse drejtuar DVP Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit².

Në këtë kuadër, është e nevojshme që në DVP Tiranë dhe komisaritet e policisë në varësi të saj, për shkak të shtrirjes së madhe territoriale dhe dinamikës që ka Qarku Tiranë, të rriten kapacitetet fizike të dhomave të sigurisë për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin në mënyrë dinjitoze të personave të arrestuar/ndaluar, sipas të drejtave të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Në dhomat e sigurisë, trajtohen personat e ndaluar apo të arrestuar në moshë madhore, ndërsa personat e ndaluar/arrestuar femra dhe të mitur, në përfundim të veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë, shoqërohen menjëherë për në ambientin e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Në kohën e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodhej vetëm 1 person në cilësinë e të arrestuarit në flagrancë, por sipas informacionit të përgjegjësit të dhomave të sigurisë, ky shtetas në momentin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore, kishte deklaruar se ishte i infektuar prej disa ditësh me COVID-19. Personi që në momentin e deklarimit mbahej i veçuar, ishte pajisur me maskë mbrojtëse dhe ishte akomoduar në një nga dhomat e sigurisë. Ndërkohë që punonjësit e policisë kishin njoftuar familjen e tij për të sjellë ilaçet e rekomanduara nga mjeku i poliklinikës. Në këto kushte, grupit të inspektimit vendosi që mos të hynte në dhomën e sigurisë të këtij shtetasi dhe mos të kryenim intervistimin e tij.

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura me krevat vetëm për një person, ndërsa personat e tjerë flinin me dyshekë të vendosur në dysheme. Ndërkohë, dhomat ishin të kompletuara me

² Nga institucioni jonë janë kryer hetimet e nevojshme administrative dhe janë në proces rekomandimet e veçanta për këtë situatë.

dyshekë, batanie dhe jastëk për 4 persona. Dritaret e dhomave të sigurisë, mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit, por jo të dritës natyrale. Ambienti i sigurisë kishte ndriçim nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje, ambienti i sigurisë furnizohej nga gjeneratori që ishte në gjendje pune.

Sa më sipër, në procedurat standarde parashikohet se dhomat e sigurisë duhet të garantojnë “qëndrim dhe jetesë normale” të personave të ndaluar/arrestuar. Gjithashtu, në kriteret e ndërtimit të dhomave të sigurisë, përcaktohet qartë se, sipërfaqja e përgjithshme për një të arrestuar/ndaluar duhet të jetë jo më pak se 10 m², e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².³

Sikurse theksuam, grupi i inspektimit nuk mundi të intervistonte personin në cilësinë e të arrestuarit që ndodhej në dhomën e sigurisë, por nga intervistimi i përgjegjësit të dhomave të sigurisë rezultoi se, personat e ndaluar/arrestuar furnizohen rregullisht me paketën higjieno-sanitare, si dhe pajisjen me maska dhe dezinfektantë për mbrojtjen nga COVID-19, për ditët e qëndrimit në këto ambiente.

Gjithashtu, nga verifikimi i grupit të inspektimit të fashikujve që ndodheshin në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, çdo person pranohej në ambientin e sigurisë kur ishte i pajisur nga OPGJ me setin e dokumenteve si a) proces-verbalin e arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore, prokurori, urdhri i ekzekutimit të prokurorit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor; b) procesverbalin e kontrollit personal së bashku me sendet personale të cilat janë konstatuar dhe gjetur gjatë kontrollit; c) një nga dokumentet zyrtare të identifikimit, si dhe d) kopje të kartës me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar.

Në ambientin e sigurisë ndodhej vetëm një tualet, i cili kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm dhe një dush me ujë të ngrohtë për larjen e trupit.

Në ambientet e sigurisë ishte vetëm një dhomë, e cila përdorej njëkohësisht si dhomë për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga prokurori apo oficerët e policisë gjyqësore, për takime me avokatët mbrojtës, dhomë e mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore, si dhe zyrë e përgjegjësit të dhomave të sigurisë për mbajtjen e dokumentacionit dhe regjistrave.

Kjo dhomë ishte e pajisur me orendi si tavolina për punë, karrige për qëndrimin ulur të personave të arrestuar/ndaluar, një krevat për kryerjen e vizitave mjeksore, rafti për mbajtjen e medikamenteve mjeksore, si dhe rafti për mbajtjen e dokumentacionit të përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Referuar procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, këto

³ *Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

ambiente si dhoma për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga prokurori apo oficerët e policisë gjyqësore dhe për takime me avokatët mbrojtës, dhoma për kryerjen e vizitave mjeksore, si dhe dhoma e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, duhet të jenë detyrimisht të ndara më vehte, për shkak të funksioneve të ndryshme që ka secila dhomë.

Ambientet e dhomave të sigurisë nuk kishin sistem qendror për ngrohje dhe ftohje. Por, për periudhën e dimrit, komisariati kishte marrë masa për kompletimin e dhomave me pajisje elektrike për ngrohje, të cilat ishin nën administrim të përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte një telefon fiks për komunikimin e personelit të shërbimit me sallën operative në rast nevojë, ndërsa në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile/sinjal për komunikimin e personave të ndaluar/arrestuar me personelin e shërbimit.

Ambienti i sigurisë në këtë komisariat, përgjithësisht ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare, por kishte nevojë për lyerje dhe dezinfektim të herë pas herëshëm të këtyre ambjenteve.

U konstatua gjithashtu se, komisariati kishte burim alternativ për furnizimin me energji elektrike të dhomave të sigurisë një gjenerator, i cili përdorej në rast të ndërprerjes të energjisë elektrike dhe ishte në gjendje pune.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në korridorin dhe në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr.2 në Tiranë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar. Në korridorin midis dhomave të sigurisë, ishin të afishuara lista e organit të prokurorisë me emrat dhe kontaktet e avokatëve mbrojtës, si dhe lista e personave që kanë të drejtë të hyjnë në ambientin e sigurisë të miratuar nga drejtuesi i komisarariatit.

Ambienti i sigurisë në korridor dhe në pjesët e jashtme të tij, kishte të instaluar nga një kamera për garantimin e sigurisë fizike të këtij ambienti. Kamerat që mbanin në vëzhgim korridorin, hyrjet e dhomave të sigurisë, si dhe pjesën e jashtme të tij, pavarësisht se ishin të montuara fizikisht ato **nuk** funksiononin rregullisht. Pamjet filmike ruheshin deri në 30 ditë dhe administrimi i sistemit të kamerave të komisarariatit kryhej nga Drejtoria e IT në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Nisur nga problematikat e konstatuara në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të këtij komisarariatit nga grupi i inspektimit, rezulton se ekzistojnë ende problematika të përmendura edhe në raportin e CPT (European Committee for the Prevention of Torture), gjatë vizitës së fundit monitoruese të mbajtur nga data 20 deri 30 Nëntor 2018 në Shqipëri⁴.

⁴ <https://rm.coe.int/16809cb571>, rekomandimi 8, faqe 14, pergjigje e Qeverise Shqiptare ne lidhje me rekomandimet e CPT.

Në këto kushte, vlerësojmë hapat e ndërmarrë nga Policia e Shtetit për ndërtimin e objektit/bllokut të sigurisë për Drejtorinë/komisariatet e policisë Tiranë, sipas edhe angazhimit të qeverisë shqiptare në përgjigje të rekomandimeve të CPT. Por, inkurajojmë përfundimin e punimeve nga ana e operatorit ekonomik, që ka marrë përsipër ndërtimin e këtij objekti brenda 24 muajve (marrja në dorëzim në muajin Dhjetor 2021), sipas afatit kontraktor lidhur me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë⁵.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodhej një person i arrestuar. Për periudhën Janar-Mars 2021 në regjistrin e të dhënave për personat e ndaluar/arrestuar ishin evidentuar 74 persona.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”⁶ dhe “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”⁷, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, grupi i inspektimit konstatoi se, Komisariati i Policisë nr.2 Tiranë, ishte i plotësuar me regjistrat e përcaktuar në procedurat standarde. Ato mbaheshin në një raft në dhomën e përgjegjës të dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit, si dhe administroheshin prej punonjësve të policisë të ngarkuar me këtë detyrë. Regjistrat ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Konkretisht, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” bashkëlidhur procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit, si dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit⁸.

⁵ Kontrata Nr.1412, datë 14.08.2019 me operatorin ekonomik "HASTOCI" shpk për ndërtimin e zonës së Sigurisë në DVP Tiranë.

⁶ Kreu VII, pika 5

⁷ Kreu XI, pika 1

⁸ Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Gjithashtu, në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e policisë së këtij komisariati.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, në rastet e arrestimeve në flagrancë, ora e arrestimit e shënuar në procesverbalin e arrestimit, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në mjediset e komisariatit të policisë.

Krahas tyre, pjesë e dokumentacionit që administrohej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, ishte edhe regjistri i posaçëm për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisariati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Për periudhën që u zhvillua inspektimi Janar-Mars 2021 ishin evidentuar 4 kërkesa nga ana e personave të arrestuar/ndaluar me objekt si për njoftimin e familjeve dhe për njoftimin e avokatit mbrojtës nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë, të cilat (sipas shënimeve në regjistër) ishin plotësuar nga punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë nr.2 në Tiranë, kishte vetëm një person në cilësinë e të shoqëruarit. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodhej 1(një) person në cilësinë e të arrestuarit në flagrancë.

Grupi i inspektimit intervistoi personin e shoqëruar, i cili deklaroi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës të qëndrimit në ambientin e shoqërimit të komisariatit dhe ishte brenda limitit kohor të shoqërimit. Në deklaratën e personit të shoqëruar, u konstatua se, gjatë ndalimit nga punonjësit e policisë ata ishin identifikuar përpara tij duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Përsa i takon marrjes në pyetje, punonjësit e policisë të komisariatit ishin në pritje të oficerëve të policisë gjyqësore të organit të prokurorisë për krimet e rënda, për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Ndërsa, me personin e arrestuar në flagrancë, grupi i inspektimit nuk mundi të zhvillojë intervistë, për shkak se ai kishte deklaruar se ishte i infektuar me COVID-19 (sipas shënimeve në kartelën mjeksore të firmosur nga mjeku i DVP Tiranë) dhe ishte izoluar në njërën prej dhomave të sigurisë. Ndërkohë, nga ana e përgjegjësit të dhomave të sigurisë ishte njoftuar familja e tij, për dërgimin e ilaçeve dhe rrobave për veshje.

Nga informacioni i grumbulluar gjatë inspektimit dhe kontrolli i regjistrit, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik brenda ambienteve të këtij Komisarati apo ndonjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sikurse

përcaktohet në neni 133 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 293, datë 8.4.2015 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuro-paralizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia e shtetit”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për miratimin e procedurave standarde të Departamentit të Sigurisë Publike “Për përdorimin e forcës”, si dhe në procedurën standarde për trajtimin e personave të arrestuar apo të ndaluar.⁹

Gjithashtu, nga intervista me personin e shoqëruar nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarit ishte i qetë dhe nuk dëshmonte për ndonjë pasojë të shkaktuar nga keqtrajtimi.

Personave të ndaluar/arrestuarve, ju jepej nga oficerët e policisë gjyqësore kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit, ajo e kontrollit personal, si dhe kopje e kartës me të drejtat e tyre. Koha e qëndrimit të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor.

Të ndaluarve/arrestuarve, u mundësohej trajtimi me ushqim 3(tre) herë në ditë, me shërbim katering sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin nr.189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat, sipas kontratës të lidhur mes institucionit dhe subjektit privat.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte vende të posaçme kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatit e Policisë nr.2 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera. Nga monitorimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë në këtë komisarjat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndërkohë, sikurse përmendëm edhe më lart, në këtë komisarjat nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi, por marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar apo të

⁹ *Kreu V, pika 6 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

ndaluar/arrestuar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilat nuk ishin të monitoruara me kamera.

Lidhur me këto fakte, Avokati i Popullit i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe drejtorive vendore të policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar¹⁰.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë, nuk ka dhomë më vete për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orëditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të fëmijët.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në këtë komisarjat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi se, për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vehte një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

¹⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Gjatë inspektimit u informuam se, personat e ndaluar/arrestuar madhor të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat, mundet tu kërkonin punonjësve të policisë ndihmë juridike për t'ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Personave të ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj, ju mundësohej dhënia e kartës për tu njohur me të drejtat e tyre, e cila ishte e përkthyer në 6 gjuhë të huaja, në momentin kur këta persona hynin në ambientin e sigurisë.

Në lidhje me dhënien e kartës me të drejtat e personave që shoqërohen në mjediset e policisë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar vendosjen e një standardi të ri që kopja e kartës me të drejtat që gëzojnë personat që shoqërohen në këto mjedise, tu jepet që në momentin që atyre ju privohet liria, pra kur hyjnë në dhomat e shoqërimit, dhe jo vetëm kur ata hyjnë në dhomat e sigurisë. Ky standard do të garantojë më së miri të drejtat e këtyre personave, si dhe besueshmërinë e qytetarëve të shteti së drejtës (parimi i sigurisë juridike).

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin menjëherë për në dhomat e sigurisë të DVP Tiranë, për veprime procedurale të mëtejshme, në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut në organikë të kësaj drejtorie.

Përsa i përket trajtimit mjekësor të personave ndaluar/arrestuar, u konstatua se ky shërbim ofrohej nga mjeku i cili është në organikë të DVP Tiranë. Në rastet kur këta persona kishin nevojë për vizita mjeksore të mjekët specialist, njoftohet menjëherë shërbimi i urgjencës kombëtare dhe personat shoqërohen në QSUT “Nënë Tereza”. Nga kqyrja e dokumentacionit, personat e ndaluar/arrestuar kishin kryer vizita mjekësore brenda afatit prej 12 orëve dhe sa herë është kërkuar prej tyre.

Vizitat mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, konstatimet, rekomandimet e mjekut dhe medikamentet e dhëna, pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për garantimin e kushteve të përshtatshme në dhomat e sigurisë duke i pajisur ato me shtrat për fjetje sipas kapacitetit fizik, me qëllim trajtimin njerëzor e dinjitoz të personave të arrestuar/ndaluar.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien dhe mbajtjen në funksion të plotë të sistemit audio-viziv me kamera në Komisarriatin e Policisë nr.2, Tiranë, i cili shërben për mbajtjen në vëzhgim të ambientit të shoqërimit dhe ambientit të sigurisë, si dhe për këqyrjen e veprimeve të punonjësve të policisë në këto ambiente dhe në dhomën e marrjes në pyetje apo gjatë intervistimit të personave që shoqërohen në mjedisit e këtij komisarriati.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës me të drejtat personave të shoqëruar që në momentin e shoqërimit të tyre në mjediset e komisarriatit të policisë, si dhe vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar brenda në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është efektive nëse janë të vendosura vetëm në korridorin e ambientit të shoqërimit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për lyerjen dhe dezinfektimin e dhomave të sigurisë dhe të shoqërimit, me qëllim krijimin e një ambienti të pastër nga ana higjeno-sanitare, si dhe për parandalimin e përhapjes së COVID-19 në mjediset e komisarriatit.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës të intervistimit dhe marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruarve, si dhe për kryerjen e veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore. Instalimin e sistemit të monitorimit me kamera brenda saj.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës për intervistimin e fëmijëve të mitur, e cila duhet të jetë e kompletuar me orënditë dhe pasijet e nevojshme, për një ambient sa më miqësor dhe trajtim dinjitoz të tyre.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore, të kompletuar me orënditë e nevojshme, si dhe pajisjen me frigorifer për ruajtjen dhe sigurimin e medikamenteve.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ermonela XHAFA